

VENDIM
Nr.250, datë 27.4.2007

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT NR.7352/03, DATË 22.8.2006 TË GJYKATËS
EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, PËR ÇËSHTJEN “BESHIRI DHE TË
TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të konventës europiane për të drejtat e njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit nr.7352/03 të datës 22.8.2006 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen “Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në vlerën 126 000 (njëqind e njëzet e gjashtë mijë) euro.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 12 maj 2007.

3. Shuma prej 126 000 eurosh të depozitohet në njerën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve “Beshiri dhe të tjerë”, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

4. Shuma e depozituar sipas pikës 3 të këtij vendimi, e cila do t'i paguhet ankuesve “Beshiri dhe të tjerë”, të përballohet nga Ministria e Financave, nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë speciale, përkundrejt paraqitjes të së gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm, për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha